

PROCESVERBAL

Ky proces-verbal mbahet sot ne sallën e mbledhjeve të selisë qendrore të Bankës CREDINS në orën 17.00 për qëllime të dokumentimit të minutave të takimit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë tregtare **SiCRED sh.a.** (Shoqëri Sigurimi Jete), njoftuar me shkresën nr.411 prot., datë 08/04/2011, dhe objekt “Mbi zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë tregtare SiCRED sh.a. në datën 14.04.2011”.

Janë pjesëmarrës në takim të këta anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a., si më poshtëshënuar:

1. z. Artan SANTO (kryetar)
2. z. Selman LAMAJ (anëtar)

Në respektim të rendit të ditës pika e parë që diskutohet, lidhet me miratimin e projekt-vendimit të propozuar “Mbi programin e punës të kontrollit të brendshëm të shoqërisë SiCRED sh.a. për vitin 2011”. Në përfundim të diskutimit projekti i propozuar u miratua nga të dy pjesëmarrësit ne takim Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a., dhe u nënshkrua në respektivisht të tre kopjet Vendimi përkatës.

Pika e dytë e rendit të ditës që diskutohet, lidhet me “Njohjen me bilancin paraprak të shoqërisë SiCRED sh.a., sipas formatit të AMF-së për vitin financiar 2010, përpara certifikimit nga Eksperti Kontabël i Pavarur dhe kalimit për miratim në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë SiCRED sh.a.”. Në përfundim të diskutimit, projekti i propozuar u miratua nga të dy pjesëmarrësit në takim Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a., dhe u nënshkrua në respektivisht të tre kopjet Vendimi përkatës.

Takimi u mbyll në orën 17.45. Ky proces-verbal, u mbajt nga znj. Vjosa BODO nën cilësinë e Sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës, në dy kopje identike dhe u nënshkrua nga të dy Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë SiCRED sh.a. pjesëmarrës në mbledhje, si dhe nga Sekretarja e Këshillit prezent në mbledhje. Të dy kopjet e mbajtura për qëllime të dokumentimit të minutave të takimit ju dorëzuan z. Genc KOXHAI, nën cilësinë e Administratorit të shoqërisë SiCRED sh.a..

Mbyllet me nr.1 faqesh. Bashkëlidhur proces-verbalit gjësinë të një pjesëmarrëseve, si dhe aktin e njoftimit të takimit për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të datës 14.04.2011.

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

z. Artan SANTO

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës

z. Selman LAMAJ



Sekretare
Znj. Vjosa BODO



